



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**KOMUNIKATË PËR SHTYP**

Në kuadër të Thirrjes së Hapur për Projekte për realizimin e Pavijonit Shqiptar në edicionin e 16-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Arkitekturës – Bienale e Venecias, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, përgëzon të dy ekipet e kualifikuar për fazën e tretë të procesit selektiv për pasionin, angazhimin dhe profesionalizmin e projekteve të paraqitura.

Ministria e Kulturës shpall se projekti që do të përfaqësojë Shqipërinë në edicionin e 16-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Arkitekturës në Bienalen e Venecias 2018 është “Hapësira zero”, i paraqitur nga Commonsense, Studio/PRGBR Arkitektur FABLAB, Tirana.

Ky projekt u përzgjedh nëpërmjet një thirrjeje të hapur për projekt-propozime (2 gusht – 3 nëntor 2017), shpallur nga Ministria e Kulturës në rolin e komisionerit të pavijonit të Shqipërisë, në vijim të tre fazave të procesit selektiv, nga një juri ndërkombëtare e përbërë nga: z. Gëzim Qendro, z. Bekim Ramku, z. Simon Battisti, zj. Adelina Greca dhe zj. Arta Dollani.

Anëtarët e jurisë arritën në përfundimin se ky është projekti më i mirë dhe ekipi më bindës për realizimin e sukseshëm të pavijonit shqiptar në Bienale, i cili përmbush kriteret e paraqitura në thirrjen e hapur.

Juria u frymëzua nga lidhja e propozuar nga ekipi midis Venecias dhe Tiranës për të sjellë një pjesë të mjedisit urban të Tiranës në Venecia, një pjesë që Tirana po humbet në procesin e zgjerimit urban / rindërtimit.

**Projekti \_ Hapësira Zero**

Pasuria e ritualeve dhe metodologjive të traditave shpirtërore, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim, i atribuon “portës” një simbologji të gjërë dhe të pasur me domethenie. Në kultura të ndryshme, akti i “kalimit të pragut”, ka pra domethënien e bashkimit me një botë të re, dhe njëkohesisht porta përfaqëson ndarjen dhe komunikimin e dy ambjenteve, jo thjesht si mjet identifikues i kufijve të hapësirës ndërmjet një ambjenti të brendshëm apo të jashtëm dhe anasjelltas, por edhe si kalim mes dy nivelesh: e njohura dhe e panjohura, hyjnorja dhe njerezorja. Është edhe për këtë arsye që kemi zgjedhur portat si element për të shpjeguar Tiranën; atë të vjetër dhe atë moderne. Seria e dyerve e instaluar në ‘Hapësirën Zero’ linjëzon kalimin mes të brendshmes dhe të jashtëmes në urbanistikën bashkëkohore të Tiranës, karakterizuar nga prezenca e shumë dyqaneve, punishteve, kafeneve, të pranishëm kudo nëpër qytet dhe pothuaj 24 orë në shërbim të qytetit. E gjithë kjo, bazuar në iniciativen personale dhe kolektive, në një liri totale veprimi drejt modifikimit të katit përdhe nga një zonë krejtësisht private në një hapësirë pothuaj krejtësisht publike. Pa kompleksin e ruajtjes së identitetit apo të krijimit të një stili urbanistik por thjesht në formimin e një stili jetese tashmë dukshëm veçori e patjetërsueshme e këtij qyteti. Duke hapur një derë, duke mbyllur një tjetër, duke transformuar dhe modeluar hapësirat, duke u adaptuar me ndryshimin konstant që dinamikat e kësaj mënyre jetëzimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

kërkojnë papushim. Dyer të hapura që tradicionalisht në mort dhe gezim në Shqipëri ishin simbol i komunitetit të bashkuar rreth Njeriut.

'Freespace' interpretohet si çlirimi i hapësires në nivelin zero, për të krijuar qytetin ku të gjithë i shërbejnë diçka dikujt. Nëpërmjet shërbimit të një kafeneje apo të një këpucari, berberi, rrobaqepsi apo kasapi, ky nivel, ashtu, shtruar, ngadalë por në një kaos që me evolimin e tij spontan, ndryshe nga planifikimi tipik i territorit, ndryshe nga ndonjë model tjetër, ka krijuar qytetin ku hapësira publike ngjan me një media sociale fizike, me këmbë në tokë, në katin përdhes.

'Hapësira Zero' në katin përdhes të qytetit, merr përsipër një rol social që mundësohet nga prania e kudondodhur e dyqaneve të vogla dhe shërbimeve të shumëllojshme brenda në qytet, si burime hapësinore në resonance me bujarinë e dhuratave të natyrës. Qytetarët e Tiranës projektojnë jetët e tyre mes sigurisë së katin përdhes të qytetit ku ata lirshëm ndërveprojnë mes njëri tjetrit, kësaj duke u lidhur ngushtësisht me territorin, i cili në rastin e një qyteti përkthehet me ambjentet përreth banesave, në "Hapësira Zero". Pjesëmarrja aktive dhe sensi i komunitetit gjen vend duke formëzuar jetesën në oportunitetet e ofruara në nivelin zero të qytetit.

Dyert e dyqaneve të Tiranës janë linja komunikimi. Nuk ndajnë të huajën nga e mbyllura e sigurt, nuk ndajnë pra "kaosin" nga "kozmosi". Në Tiranë portat janë hapësira të kthyer në zgjatime që organizojnë urbanistikën. Pasuri e një culture antike e adaptuar në mënyre kreative me nevojat e përditësuara të qytetarëve për një hapësirë totalisht në dispozicion, një hapësirë të lirë për publikun. Për keto arsye, "Hapësira Zero" e Tiranës ridimensionon qytetin në shkallë njerëzore, duke u kthyer tashmë në këtë hapësirë ku gjeneratat e ardhshme njohin vetveten.

Ekipi përkthen dhe interpreton natyrën e çastësishme të jetës së Tiranës, kap një moment nga fluksi i saj dhe ja dorëzon atë publikut të Biennales. Ky instalacion interpreton pozitivisht një fenomen që lind si social por që përkthehet në një energji që modelon nëpërmjet arkitekturës së qytetit të gjithë menyrën tonë të jetës, në një pikëtakimi domethënëse të njeriut me hapësirën. Tirana hap pra dyert e saj komode, plot ngjyra dhe tinguj primordialë, në Biennalen e 16 Ndërkombëtare të Arkitekturës.

### **Commonsense.Studio/PRGBR Arkitektur FABLAB Tirana**

PRGB R arkitektur është një studio arkitekture me qendër në Tiranë, aktiviteti i së cilës nga viti 2005 është shtrirë në fushat e arkitekturës, urbanizmit dhe kërkimit. E përfshirë në mënyrë shumë aktive në dizajnin e hapësirave publike, banesave dhe ndërtesave qytetare, PRGB R Arkitektur drejtohet nga bashkëpunëtorë me përvojë të madhe dhe të rinj entuziastë që synojnë të vënë në jetë vizionin e tyre në zhvillimet dhe kompeticionet në vend.

### **Ekipi**

#### **Drejtuesi i Ekipit**

#### **Dorian Tytymçe – Arkitekt**

Anëtar i "Shoqatës së Arkitektëve të Shqipërisë". Duke filluar nga 2014 ai është partner / Arkitekt projektues urban në PRGB R Arkitekture Office. Nga 2011 e në vazhdim është pjesë e Departamentit të Arkitekturës, Universiteti Epoka. Gjatë 2009-2014 është angazhuar profesionalisht në fushën e



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

projektimit dhe zbatimit. Disa projekte të rëndësishme në të cilët ka marrë pjesë në mënyrë aktive në fazën e projektimit dhe implementimit, në bashkëpunim me zyrat e njohura të arkitekturës ndërkombëtare janë:

- Ndërtesa 9-katëshe në ndërtim 9-katëshe në rrugën Bogdani, Tiranë: Henning Larsens Tegnestue
- Qendra Tregtare Toptani, një kompleks ndërtimi 7-katësh në rrugën "Murat Toptani", Tiranë: MVRDV.

Gjatë 2008 – 2009 ka qenë partner në "Apricot", Arkitekture/Urbanism Office në Tiranë. Prej vitit 2005 ka marrë pjesë në kompeticione të ndryshme ndërkombëtare.

**Anëtarë të tjerë të Ekipit**

Jurtin Hajro, Arkitekt  
Florian Pollo, Arkitekt  
Enri Leka, Model maker  
Egin Zeka, Planifikues urban  
Elton Koritari, Kurator ekspozitash  
Genti Tavanxhiu, Artist / Skulptor  
Jonid Koritari, Artist Audio  
Artemis Hajdini, Artist Video  
Laedia Hajdari, Artiste Skenografe  
Mirjana Pali, Cultural Mediator  
Eni Molla, Content Manager  
Anisa Hysko, Koordinatore MP & Financimi

Ekipi i kompozuar me kujdes ka si emërues të përbashkët qasjen e thellë kritike ndaj projektimit, një qasje që kërkon stimujt jo vetëm në botën vizuale, por gjithashtu inspirohet nga pëlhura sociale, njerëzimi, historia dhe kultura lokale si e tërë. Procesi synoi të vetëçlirohet nga cdo kompleks social, politik apo arkitektonik, dhe të vrojtojë shkëmbimin e përditshëm mes njëriut dhe arkitekturës në gjithë komponentët e tij kulturor si fluks energjie që formëzon jetën e pasur sociale në Tiranën bashkëkohore.

---

**JURIA NDËRKOMBËTARE**

▪ **Gëzim Qendro\_Kryetar**

Profesor i Asociuar i Teorisë së Artit dhe Kritikës, Përgjegjës i Departamentit të Arkitekturës dhe Dezajnit, në Universitetin POLIS, në Shqipëri. Edukimi i tij përfshin diplomë bachelor në Academie voor Beeldende Vorming, Amsterdam, Hollandë (1992-1996) dhe gradën e doktoraturës në Estetikë në University Paris VIII (2009) për pikturë. Ka qenë drejtor arti i



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

filmave të animuar në ish Kinostudion “Shqipëria e Re”, Drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë (1997-2002), drejtor i revistës së artit PamorART” (1998-2002), bashkëdrejtor dhe një nga kuratorët e tre edicioneve të para të Bienales në Tiranë, kurator i ekspozitave “Surrealizmi socialist”, “Homo Socialisticus”, “Post EVA”, “Nostalgji”, “Glocal”; bashkëkurator i ekspozitës “In & Out”; ka marrë pjesë në konkursin e përvitshëm mbi artin bashkëkohor Onufri (1997, 2001). Që prej vitit 1992 ka botuar mbi 100 artikuj në shtypin shqiptar dhe të huaj mbi çështje të lidhura me historinë e artit shqiptar. Është autor i tre monografive për artistët shqiptarë dhe përkthyes i 14 titujve librash të lidhura kryesisht me historinë e artit dhe teorinë e artit.

▪ **Simon Battisti**

Arkitekt që zhvillon aktivitetin në Tiranë. Në vitin 2016, ai ka qenë kuratori i “I Have Left You the Mountain”, me të cilin u përfaqësuan pavijoni shqiptar në Bienalen e Arkitekturës së Venecias, së bashku me Leah Whitman-Salkin dhe Åbäke. Studimet e tij fokusohen në zhvillimet e qendrës së Tiranë gjatë viteve 90-të.

Është redaktor i Flexible Leviathan: Rikonsiderimi i Shkallës dhe Fiksimit në Iztapalapa, Mexico City (Harvard GSD, 2016), me Diane Davis dhe Jose Castillo. Z. Battisti shkruan rregullisht për arkitekturën dhe urbanizmin në revista të ndryshme profesionale, së fundmi në Log, Clog, etj. Projektet e tij të fundit janë mbështetur nga Fondacioni Fulbright, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT); Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim (GIZ); Instituti për Demokraci, Medime dhe Kulturë; si dhe Bashkia e Tiranës.

▪ **Bekim Ramku**

Bekim Ramku është arkitekt dhe urbanist nga Kosova. Ai është Drejtor i Fondacionit të Arkitekturës së Kosovës dhe drejton Zyrën e Hartuesve Urbanë dhe Arkitektëve, një studio arkitekture dhe urbanistike e themeluar prej tij në vitin 2012 në Prishtinë. Ka diplomë Master në Strehim dhe Urbanizëm nga Shkolla e Arkitekturës në Londër dhe Diplomë në Inxhinieri Arkitekurore nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë Civile.

Z. Ramku ishte iniciator dhe Asistent Komisioner i Kosovës për here të pare në Bienalen e Venecias në vitin 2012 dhe gjithashtu komisioner i Pavijonit të Kosovës në Bienalen e Venecias në vitin 2014. Ai është gjithashtu themelues, drejtor dhe kurator i Javës së Arkitekturës në Prishtinë. Përveç kësaj, Z. Ramku ka shërbyer si këshilltar i jashtëm i Ministrisë të Kulturës të Kosovës për çështjet e trashëgimisë kulturore dhe infrastrukturës. Ai është një konsulent ndërkombëtar i NACTO Global Design Street Design dhe është Koordinator Rajonal për Evropën Juglindore për Çmimin Aga Khan për Arkitekturë.

▪ **Adelina Greca**

Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit. Është diplomuar për arkitekturë në Universitetin Middle East Technical, Fakulteti i Arkitekturës, Ankara, Turqi dhe ka vazhduar studimet post universitare në fushën e Planifikimit Urban. Ka marrë pjesë në hartimin e Planit



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

të Rregullimit të Territorit të Tiranës dhe ka eksperiencë në organizimin dhe planifikimin e kompeticioneve kombëtare e ndërkombëtare të fushës. Duke filluar nga viti 2011 e në vazhdim ajo është edhe lektor me kohë të pjesshme pranë Universitetit Epoka.

▪ **Arta Dollani**

Pas diplomimit për Arkitekturë në Krakov të Polonisë, ka punuar për një kohë të gjatë në Bashkinë e Tiranës si planifikuese urbane, duke zhvilluar paralelisht përvojën akademike në mësimdhënie pranë Fakultetit të Arkitekturës. Bashkëhartuese e një numri të konsiderueshëm projektesh rikualifikimi urban, ajo zotëron përvojë cilësore në projektim e implementim. Aktualisht drejtoreshë e përgjithshme e Institutit të Monumenteve të Kulturës, është bashkëautore e projekteve të shumta në fushën e restaurimit dhe muzealizimit. Ajo gjithashtu ka qenë anëtare në disa jurindërkombëtare të konkurseve arkitektonike.

---

**PAVIJONI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBIKQYRET NGA MINISTRIA E KULTURËS**

<b>KOMISAR:</b>	<b>Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë</b>
<b>PROJEKTI:</b>	
<b>KOHËZGJATJA:</b>	<b>26 maj deri më 25 nëntor 2018 (inagurimi 24 dhe 25 maj) në Giardini dhe Arsenale</b>
<b>SALLA:</b>	<b>Arsenale di Venezia</b>
<b>MINISTRIA E KULTURËS</b>	
<b>Adresa:</b>	<b>Rruga “Aleksandër Moisiu”, nr. 76, Tiranë, Shqipëri</b>
<b>Email:</b>	<b><a href="mailto:info@kultura.gov.al">info@kultura.gov.al</a> dhe <a href="mailto:bienale2018@kultura.gov.al">bienale2018@kultura.gov.al</a></b>
<b>Faqe web:</b>	<b><a href="http://www.kultura.gov.al">www.kultura.gov.al</a></b>
<b>PR dhe Komunikim:</b>	<b>Milena Selimi, Ministria e Kulturës</b>
<b>Mob.:</b>	<b>+35568 20 14 441; +35568 806 2673</b>
<b>e-mail:</b>	<b><a href="mailto:milena.selimi@kultura.gov.al">milena.selimi@kultura.gov.al</a></b>